

"PIJACE/TREGU" d.o.o.

Broj 22/26

Tuzi, 15.01 2026 god.



Pijace d.o.o Tuzi **Tregu** sh.p.k Tuzi

UDHËZUES
PËR QASJE TË LIRË NË INFORMACIONE NË POSEDIM
TË SHPK "PIJACE / TREGU" TUZI

Tuz, janar 2026

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit për qasje të lirë në informata ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 160/25) dhe nenit 40 të Statutit të ShPK "Pijace / Tregu" Tuzi, ushtruesi i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Shoqërisë, më 18.01.2026, miraton këtë:

UDHËZUES
PËR QASJE TË LIRË NË INFORMACIONE NË POSEDIM
TË SHPK "PIJACE / TREGU" TUZI

I. TË DHËNA THEMELORE MBI SHOQËRINË

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Pijace / Tregu" Tuzi është themeluar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Tuzit nr. 02-030/21-14528, datë 24.11.2021 ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozita komunale", nr. 40/21, datë 03.12.2021).

Emërtimi i shkurtuar i Shoqërisë është ShPK "Pijace / Tregu" Tuzi.

Shoqëria është themeluar si ndërmarrje njëanëtarëshe. Themelues i Shoqërisë është Kuvendi i Komunës së Tuzit.

Shoqëria është themeluar në periudhë të pacaktuar.

Selia e Shoqërisë është në Tuz, Tuzi bb.

Të dhëna kontakti:

tel: +382 68 092 020 email: pijacetregutz@pijacetregu-tz.me

II. LLOJET E INFORMACIONEVE NË POSEDIM TË SHOQËRISË

Informacionet në posedim të ShPK "Pijace / Tregu" Tuzi janë:

- Regjistrat zyrtar dhe të dhënat zyrtare (fragmente nga Regjistri qendror I subjekteve afariste mbi regjistrimin ,regjistri I protokollit zyrtarë ,regjistri i punëtorëve etj.)
- Vendimi për themelimin e Shoqërisë
- Statuti i Shoqërisë
- Çmimorja e shërbimeve
- Programi vjetor i punës
- Rregullore dhe akte administrative
- Kontrata
- Akte individuale (vendime dhe aktvendime)
- Procesverbale dhe vendime të organeve drejtuese

- Dokumentacion financiar dhe dokumente për prokurime publike
- Akte të tjera të brendshme të Shoqërisë

III. PROCEDURA PËR QASJE TË INFORMACIONIT

1. Nisja e procedurës

Procedura fillon me kërkesë me shkrim ose me gojë të personit që kërkon qasje në informacion.

Kërkesa me shkrim për qasje në informacion dorëzohet drejtpërdrejt, me postë ose në mënyrë elektronike (e-mail). Kërkesa gojore paraqitet drejtpërdrejt në procesverbal. Për kërkesën për qasje në informacion nuk paguhet taksë.

Kërkesa duhet të përmbajë:

- emërtimin e informacionit ose të dhëna mbi bazën e të cilave mund të identifikohet informacioni i kërkuar;
- mënyrën se si kërkohet të realizohet qasja në informacion;
- të dhënat për parashtruesin e kërkesës.

2. Mënyra e paraqitjes së kërkesës

Kërkesa për qasje në informacion paraqitet:

- Drejtpërdrejt në arkivin e Shoqërisë;
- Me postë, në adresën e Shoqërisë – Tuzi, Tuzi bb;
- Me postë elektronike në email-in e Shoqërisë: pijacetregutz@pijacetregu/tz.me.

3. Mënyra e realizimit të së drejtës për qasje në informacion

Qasja në informacion mund të realizohet përmes:

- Shikimit të drejtpërdrejtë të origjinalit ose kopjes së informacionit;
- Kopjimit ose skanimit të informacionit nga parashtruesi i kërkesës në ambientet e Shoqërisë;
- Dërgimit të kopjes së informacionit parashtruesit të kërkesës, drejtpërdrejt, me postë ose në mënyrë elektronike nga Shoqëria.

Qasja sipas pikës 1 dhe 2 realizohet në ambientet e Shoqërisë.

Shoqëria nuk është e detyruar të mundësojë qasje në informacionin që është i publikuar dhe i disponueshëm publikisht në internet.

Në rastin nga paragrafi i mëparshëm, Shoqëria do ta njoftojë me shkrim parashtruesin e kërkesës se informacioni i kërkuar është i publikuar (Fleta Zyrtare, faqja e internetit etj.).

4. Vendimmarrja sipas kërkesës dhe mbrojtja ligjore

Për kërkesën për qasje në informacion vendoset brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës së rregullt.

Kundër aktvendimit të Shoqërisë, parashtruesi i kërkesës ose personi tjetër i interesuar mund të paraqesë ankesë pranë Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Qasje të Lirë në Informacion, përmes kësaj Shoqërie.

Qasja në informacion realizohet brenda tre ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit me të cilin lejohet qasja, përkatësisht brenda pesë ditësh nga dita kur parashtruesi ka dorëzuar dëshminë për pagesën e shpenzimeve të procedurës, nëse ato janë përcaktuar me aktvendim.

Për trajtimin e kërkesave për qasje në informacione është e autorizuar Elizabeta Ivezaj, specialiste e shkencave juridike, ndërsa në rast të mungesës së saj, personi që autorizohet nga Drejtori Ekzekutiv i Shoqërisë.

IV. SHPENZIMET E PROCEDURËS

Për kërkesën për qasje në informacion nuk paguhet taksë.

Parashtruesi i kërkesës i bart shpenzimet e procedurës për qasje në informacion, të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet reale të Shoqërisë për kopjim, skanim dhe dërgim të informacionit të kërkuar, në përputhje me Rregulloren mbi kompensimin e shpenzimeve në procedurën e qasjes në informacione.

Me aktvendim mund të përcaktohen edhe shpenzime shtesë, në përputhje me nenin 33a të Ligjit për qasje të lirë në informata ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 160/25)

Shpenzimet e procedurës paguhen para ekzekutimit të aktvendimit.

Personat me aftësi të kufizuara dhe personat në gjendje nevojë sociale nuk i paguajnë shpenzimet e procedurës.

Shpenzimet e procedurës paguhen në dobi të ShPK "Pijace / Tregu" Tuzi, në llogarinë rrjedhëse nr. 520-44493-68. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk paraqet dëshmi për pagesën e shpenzimeve të procedurës, Shoqëria nuk do t'i mundësojë qasje në informacionin e kërkuar.

V. PUBLIKIMI I UDHËZUESIT

Ky Udhëzues do të publikohet në tabelën e shpalljeve të Shoqërisë, si dhe në faqen e internetit të Shoqërisë – <http://pijacetregu-tz.me>.

Përditësimi i udhëzuesit do të bëhet në përputhje me nenin 11 paragrafi 3 të Ligjit për qasje të lirë në informata ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 160/25), për çka është përgjegjëse Shërbimi për Çështje Juridike dhe të Përgjithshme të Shoqërisë.

Përpunuar nga : Elizabeta Ivezaj

Elizabeta Ivezaj

U.I D. SË DREJTORIT EGZEKUTIV

Ruzhdi Lluka



Ruzhdi Lluka



Br/Nr. 23 /26
Tuzi - Tuz, 15.01.2026. godine

Na osnovu člana 9 Odluke o osnivanju Društva sa ograničenom odgovornošću „Pijace/Tregu“ Tuzi, a u skladu sa članom 28 Statuta Društva sa ograničenom odgovornošću „Pijace/Tregu“ Tuzi, **Odbor direktora** Društva na IV sjednici održanoj dana 15.01.2026. godine, donio je

ODLUKU

1. **Usvaja se** Vodič za slobodan pristup informacijama u posjedu Društva sa ograničenom odgovornošću „Pijace/Tregu“ Tuzi, koji čini sastavni dio ove Odluke.
2. Odluka stupa na snagu danom donošenja.

Obrazloženje

Članom 11 stav 1 Zakona o slobodnom pristupu informacijama („Službeni list Crne Gore“, broj 160/25) je predviđeno da je organ vlasti dužan da sačini, objavi na svojoj internet stranici i da redovno ažurira vodič za slobodan pristup informacijama u svom posjedu.

U istom članu stav 3 propisuje se obaveza organa vlasti da vodič za pristup informacijama ažurira najmanje jednom godišnje, odnosno u roku od 30 dana od dana promjene vrsta informacija u njegovom posjedu i podataka od značaja za pristup informacijama.

Članom 9 Odluke o osnivanju Društva, kao i članom 28 Statuta je propisana nadležnost Odbora direktora Društva za donošenje akata.

Prilog: Vodič za slobodan pristup informacijama u posjedu DOO „Pijace/Tregu“ Tuzi, br. 22/26 od 15.01.2026.godine.

Broj: 23 /26
U Tuzima, 15.01.2026. godine

**ODBOR DIREKTORA DRUŠTVA
PREDSJEDNIK**

Luvigj Junčaj



Dostavljeno:

- Arhiva Odbora direktora
- a/a